

OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE
PLANI GJITHPËRFSHIRËSE I KOMUNAVE JANAR- DHJETOR 2024

Data e dorëzimit të raportit:	06.01.2025
Emri i komunës	Komuna e Ferizajt
Emri i Kryetarit të Komunës	Agim Aliu
Emri i Zyrtarit Komunal për Integritet Evropian :	Afrim Matoshi
Detajet kontaktuese:	049/995-111

• **BLLOKU I: KRITERET POLITIKE**

1. ADMINISTRATA PUBLIKE				Neni 120 i MSA-së: Administrata publike
1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal	Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ burimet njerëzore	1. A është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2024 në komunën tuaj? <i>Nëse po, ju lutemi të ofroni një dokument të tillë.</i>	1. Po në çdo vit hartohet programi i trajnimeve, poashtu edhe për vitin 2024. Në attachment të e-mailit, gjeni dokumentin e bashkangjitur.	

<p>1.2.Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal</p>	<p>Zyra e Kryetarit /Zyra e informimit</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Startegjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, nëse po ju lutem të bashkangjiteni strategjinë e miratuar?</p> <p>2. A ka komuna juaj Planin vjetor të komunikimit, nëse po ju lutem të bashkangjitni Planin ?</p> <p>3. A është duke u zbatuar Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të hapur në Komuna.</p> <p>4. A është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunën tuaj? Ju lutem bashkangjitni vendimin.</p> <p>5. Lidhur me rezultatet e procesit të konsultimit publik, a publikon komuna juaj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe a ofron sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo</p>	<p>1.Po ka te hartuar strategjinë Komunale: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/ëp-content/uploads/sites/31/2021/01/Strategjia-e-Komunikimit-Ferizaj-003.pdf</p> <p>2. Komuna e Ferizajt, poashtu ka edhe Planin Vjetor te komunikimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/ëp-content/uploads/sites/31/2022/05/Plani-i-Veprimit-per-Transparence-2022-2026-verisoni-perfundimtar.pdf</p> <p>3. Po, është duke u zbatuar plotësisht përmes zyrtares përkatëse të caktuar për konsultim publik.</p> <p>4.Po është caktuar zyrtari për koordinimin e procesit të konsultimit publik. <i>(Bashkangjitur gjeni dokumentin).</i></p> <p>5. Po, Komuna e Ferizajt publikon RAPORTET dhe PROCESVERBALET nga Konsultimet publike. Ne link gjeni publikimet: RAPORTET: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/konsultime-publike/raporte-konsultime-publike/?page=2024</p>	
---	--	---	---	--

		grupeve të tjera të interesuara. (ju lutem bashkangjitni linkun e publikimit të raporteve)?	<p>PROCESVERBALET: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/konsultime-publike/procesverbale-konsultime-publike/?page=2024</p> <p><i>Vërejtje: Nëse për çfarëdo arsye nuk i pranoni si të tilla, bashkangjitur me link, mund t'ua përcjellim të gjitha me attachment!</i></p>	
1.3.Të vazhdohet procesi i decentralizimit për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvecan, Leposaviq	Drejtoria e Administratës	<ol style="list-style-type: none"> 1. A janë emëruar Drejtorët e Drejtorive në komunën tuaj? 2. Sa është numri i Drejtorive në komunën tuaj? 3. A është themeluar Qendra për shërbim të qytetarëve? 4. A është duke funksionuar sistemi i intranetit në kuadër të shërbimeve administrative që ofron komuna juaj? 5. A është arritë të bëhet migrimi i të dhënave nga uebfaqja e vjetër në atë të re? 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po janë emëruar drejtorët e drejtorive. 2. Numri i drejtorive në komunën e Ferizajt është 11. 3. Qendra për Shërbim të Qytetarëve është e themeluar. 4. Shërbimi intranet është funksional. 5. Ende nuk është bërë web-faqja e re! 	
3.SHOQËRIA CIVILE				

<p>3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile</p>	<p>Drejtoria për Financa dhe Buxhet</p>	<p>1. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve?</p> <p>2. Sa është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna juaj ?</p> <p>3. A ka përkrahur komuna juaj, projekte të OJQ-ve për përkrahjen e komuniteteve.</p> <p>4. Nëse po, specifikoni numrin e projekteve të përkrahura dhe ju lutem ofroni shumën totale të këtyre projekteve?</p> <p>5.A është bërë publikimi i thirrjeve dhe përfituesve në web faqet zyrtare të Komunës, nëse po bashkangjit linkun.</p>	<p>1.Komuna e Ferizajt mbështet përmes thirrjeve publike dhe sipas kërkesave direkte OSHC-të në aktivitetin e tyre nga kategoria buxhetore e subvencioneve.</p> <p>2.Komuna e Ferizajt financon OSHC-të në bazë të thirrjeve të drejtorive, respektivisht Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (13 OJQ), dhe në këtë periudhë raportuese edhe nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (7 OJQ, gjithashtu ka realizuar thirrje për mbështetjen e autorëve në kuadër të DKRS.</p> <p>3.Komuna e Ferizajt mbështet OJQ pa dallime.</p> <p>4. Ne thirrjet e Komunes se Ferizajt nuk merren per baze aspekti etnik.</p> <p>5. Në vazhdimësi publikohen thirrjet në web-faqe të komunës dhe profil të facebookut të komunës: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/konkurse-njoftimet/thirrje-per-propozime/ https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2024/08/Thirrja-pdf.pdf</p>	
<p>4.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT</p>				
			<p>Neni 92: Lufta kundër terrorizmit - MSA</p>	

<p>4.1. Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre</p>	<p>Drejtoria a Arsimit/Zyra e Kryetarit</p>	<p>1. A keni organizuar ndonjë trajnim ose fushatë vetëdijësuese për parandalimin e të rinjëve që janë në rrezik për ekstremizëm dhe se si të veprojnë në raste të tilla ?</p> <p>2. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm ?</p> <p>3. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSBB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?</p>	<p>.1. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndonjë trajnim lidhur me çështjen në fjalë sepse sipas vlerësimit nuk ka pasur shenja të rrezikshmërisë. Mirëpo si temë është diskutuar në kuadër të takimeve me Departamentin e Sigurisë Publike të MPB-së dhe në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.</p> <p>2. Komuna e Ferizajt në vazhdimësi harmonizon strategjitë me akterë relevant për vetëdijësimin lidhur me ekstremizmin e dhunshëm. Bashkangjitur gjeni një nga këto takime: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/nees/komuna-e-ferizajt-e-gatshme-te-permbushe-pergjegjiesite-e-saj-qe-dalin-nga-strategjia-per-parandalim-te-ekstremizmit-te-dhunshem-dhe-radikalizmit-qe-shpie-ne-terrorizem-2015-2020-dhe-plani-i-veprimit/</p> <p>3. Në periudhën raportuese nuk ka pasur raste, por është diskutuar si temë.</p>	
<p>4.2. Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit , si dhe për zbatimin e politikave të tjera kundër korrupsionit</p>	<p>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</p>	<p>1. Sa është numri i rasteve të paraqitura të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal?</p> <p>2. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës?</p>	<p>1. Nuk ka pasur ndonjë rast të konfliktit të interesit.</p> <p>2. Të gjithë anëtarët e kuvendit janë njoftuar për përgjegjësitë e reja dhe në harmoni me ligjin kanë vepruar si të tillë. Bashkangjitur gjeni linkun e deklarimeve të anëtarëve: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/deklarimi-i-pasurise/</p>	

<p>4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion;</p>	<p>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet, konform Ligjit Nr. 08/L-017 për agjencin për parandalimin e korrupsionit nëse po ju lutem të bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. A ka komuna juaj koordinator që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet, nëse po ju lutem të bashkangjiti vendimin.</p>	<p>1. Plani Lokal për Integritet është finalizuar. Në seancën e Kuvendit Komunal më 27.06.2023 është votuar.</p> <p>https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2023/09/Model-Plani-i-integritetit-Nga-Puntoria_02_11_2022-shq.docx</p> <p>2.Pas hyrjes në fuqi, është caktuar koordinatori që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet. Shih vendimin: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2023/06/Propozim-Vendim-per-Miratimin-e-Planit-te-Integritetit-2023-2027.pdf</p>	
<p>4.4.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve</p>	<p>Zyra ligjore/Zyra informimit</p>	<p>1 Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët në përdorim zyrtarë, sipas UA. Nr. 01/2022.</p> <p>2.A publikohen të gjitha aktet komunale në gjuhët zyrtare ashtu sic parashihen me ligjin për përdorimin e gjuheve si dhe rregullores komunale për gjuhët zyrtare?</p>	<p>1.Komuna e Ferizajt ka të përcaktuar përkthyesin e gjuhës serbe, ndërsa tani posedon edhe zyrtarin që përkthen dokumentacionin në gjuhën angleze. Pra sipas listës së dokumenteve të detyrueshme por edhe sipas nevojës, të gjitha dokumentet zyrtare përkthehen në dy gjuhët zyrtare tjera.</p> <p>2.Po, në variantin e webfaqes sipas gjuhës përkatëse zyrtare.</p>	
<p>5. MBROJTJA DHE PROMOVIMI TRASHËGIMISË KULTURORE</p>				

5.1. Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore	Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)	2. A është themeluar Muzeu i Natyrës në Komunën tuaj? (Fushë Kosova)	<i>(Nuk është për Komunën e Ferizajt)</i> <i>Nuk ka të themeluar në Ferizaj, muze të këtillë.</i>	
---	---	--	--	--

<p>5.2. Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p>Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore konform Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore ?</p> <p>2. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ?</p> <p>3. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?</p> <p>4. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?</p> <p>3. A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ?</p> <p>6. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? (Vetem komunat që kanë kisha) ?</p>	<p>1. Njësia për Trashëgimi dhe shërbehet në hartimin e projekteve por ja që Komuna e Ferizajt, nuk ka një planë andaj detyrohemi të shërbehemi me Listën e Përkohshme të MKRS.</p> <p>2. Sfidat nga mungesa e hartimit është sfida e ruajtjes profesionale dhe të objekteve të trashëgimisë kulturore;</p> <p>3. Nuk posedojmë të dhëna statistikore sa i përket kësaj çështje. Por Njësia për Trashëgimi ka dorëzuar Listën e objekteve që gjenden në Ferizaj dhe një njëkohësisht janë dhënë rekomandimet se cilat objekte kanë një rëndësi të veçantë që duhet të ruhen;</p> <p>4. Ndërmarrja e masave është përmes fushatës sensibilizuese përmes medieve elektronike dhe atyre të shtypura po ashtu përmes katalogjeve dhe broshurave. Informacioneve në teren. Veprohet konform Rregullores: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/ep-content/uploads/sites/31/2020/09/RREGULLORE_01.Nr_10_P%C3%8BR_VENDOSJEN_ND_%C3%8BRTIMIN_DHE_LARGIMIN_E_OBJEKTEVE_T%C3%8B_P%C3%8BRKOHSH_PUBLIKE.pdf</p> <p>5. Megjithëse kjo çështje mbetet sfiduese, është bërë përparim në vendosjen e kamerave të sigurisë dhe sistemit të alarmimit në disa objekte të trashëgimisë kulturore, si në Muze, ku së fundmi mund të përmendim edhe shkollën e parë shqipe në Ferizaj, që është objekt nën menaxhimin e MKRS-së e ku kemi vendosur pajisje të tilla.</p> <p>6. Komuna në kuadër të punës së ndërmarrjeve publike të mirëmbajtjes ka edhe hapësirat përkatësisht oborret dhe mirëmbajtjen e hapësirave të klerit fetar, pra në kuadër të marrëveshjes që ka Komuna me kompanitë përkatëse ka të përfshira edhe objektet e kultit fetar në pikëpamje të mirëmbajtjes, po e njëjta është edhe për varrezat ortodokse ku Komuna e Ferizajt ka të kontraktuar operatorin ekonomik privat për këtë çështje.</p>	
--	---	--	--	--

<p>5.3.Zbatimi i Ligjit për Hoçën e Madhe. Krijimi i Këshillit të fshatit dhe zgjedhja e anëtarëve për zbatimin e Ligjit për Hoçën e Madhe? Arsyet nëse nuk është bërë ende dhe cilat janë planet tuaja dhe të komunës</p>	<p>Sekretaria e Kuvendit Komunal/Zyra për Fshatin Hoqë e Madhe</p>	<p>1. Cilat janë veprimet që komuna e Rahovecit ka ndërmarrë për funksionimin e Këshillit për Hocën e Madhe?</p> <p>2. A është alokuar buxheti për Këshillin e fshatit të Hoqës së Madhe për të mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?</p>	<p><i>(Nuk është për Komunën e Ferizajt)</i></p>	
<p>5.5.Ndërmarrja e veprimeve në adresimin e problemit të ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura (ZVM)? Raportim mbi aktivitetet e ndërmarrja nga Task Forca e ngritur për t'u marrë posaçërisht me ndërtimet e paligjshme në Prizren. Planet e ardhshme për këtë Task Force sipas qeverisë së re</p>	<p>Sekretaria e Kuvendit Komunal</p>	<p>1. Cilat janë veprimet e komunës për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit?</p>	<p><i>(Nuk është për Komunën e Ferizajt)</i></p>	

		<p>2.A është alokuar buxheti për këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit për të mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?</p> <p>3.Sa është numri i ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit?</p> <p>4.Çfarë aktivitete ka ndërmarrë Task Forca për sa i përket ndërtimeve të paligjshme, në Komunën e Prizrenit?</p> <p>5. A janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit?</p> <p>6. Cfarë aktivitete ka ndërmarrë komuna e Prizrenit me qëllim të rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardhi?</p>	<p><i>(Nuk është për Komunën e Ferizajt)</i></p>	
<p>5.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p>Drejtoria e Kulturës</p>	<p>1.Listoni aktivitetet që komunat ka ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Vizitë në Muzeu i Qytetit në Ferizaj ka të organizuara si nga shkollat fillore po ashtu edhe ne shkollat e mesme andaj, kjo ndihmon afirmimin e Trashëgimisë kulturore të Ferizajt; • Vizitat në fshatrat e Ferizajt nga ana e përfaqesuesit të Trashëgimi dhe Muze; 	

- | | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | | | <ul style="list-style-type: none"> • Në kuadër të shënimit të Ditës së Mësuesit 7 marsit, Muzeu i Qytetit në Ferizaj hap ekspozitën me fotografi "Rrugëtimi i Shkollës Shqipe në Ferizaj" • Në kuadër të shënimit të përvjetorit të demonstratave të vitit 1981, Njësia për Trashëgimi dhe Muze në bashkëpunim Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës do të organizojnë ekspozitë me dokumente dhe fotografi historike për njërin prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë e Kosovës. • Në kuadrin shënimit të 18 majit Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Muzeu Qytetit sot ka bërë hapjen e ekspozitës para bibliotekës, ku u prezantua trashëgimia kulturore e trevës së Ferizajt; • Njësia për Trashëgimi dhe Muze, ka nisur me ligjërata për nxënësit e shkollave të mesme; • Njësia për Trashëgimi dhe Muze ka organizuar Konferencën "Gjendja e muzeve gjatë Pandemisë"; • Në vazhden e aktiviteteve të Njesisë për Trashëgimi dhe Muze, kemi nisur me ligjërata nëpër shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Ferizajt; • Prezantimi në media elektronike dhe të shtypura të trashëgimisë kulturore; • Në kuadër të Ditëve të Kulturës, Njësia për Trashëgimi dhe Muze, ka organizuar një prezantim, temë trajtimi pati veshjet | |
|--|--|--|---|--|

			<p>tradicionale të trevave shqiptare;</p> <ul style="list-style-type: none"> Në kuadrin e aktiviteteve që mbahen për "Ditët e Kulturës" Njësia për Trashëgimi dhe Muze, organizon një Ekspozitë, me temën "Kosova në arkivin e shtetit shqiptar". Format e bashkëpunimit janë në rrafshin trashëgimor dhe në krijimin e një serë bashkëpunime; Promovimi përmes publikimeve në rrjete sociale të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe monumenteve historike në Ferizaj. <p>Përfshirja në kuadër të guidës turistike, fizike dhe elektronike si dhe në udhërrëfyesin për Ferizajn të objekteve të tilla.</p>	
--	--	--	---	--

2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIKE

1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT

1.1. Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit në të bërit biznes si dhe procedurat e planifikimit të buxhetit	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	<p>1. A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (<i>one-stop shopet</i>) në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i inspektorëve të tregut në komunën tuaj?</p> <p>3. Sa është numri i inspektimeve gjatë periudhës raportuese?</p>	<p>1. Po</p> <p>2. Numri i inspektorëve të tregut është 3.</p> <p>3. Inspektime me procesverbal janë 195.</p>	
--	---------------------------------	--	---	--

		<p>4. Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit?</p> <p>5.Sa është numri i bizneseve të regjistruara, ju lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2024 ?</p> <p>6. Sa është numri i bizneseve të mbyllura, ju lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2019 ?</p> <p>7.Sa është numri i bizneseve të udhëhequr nga gratë?</p> <p>8.Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për subvencionimin e bizneseve?</p>	<p>4. Për përgatitjen e kornizës buxhetore në vitin 2024 janë mbajtur një takim me kryetar të bashkësive lokale, një diskutim publik me qytetarë, takimi në Komitet për Politikë dhe Financa dhe mbledhja e Kuvendit Komunal të Ferizajt,</p> <p>5. Numri i bizneseve të regjistruara për periudhën raportuese është 789 SHPK dhe 214 B.I.</p> <p>6. Numri i bizneseve të mbyllura është 84.</p> <p>7. Numri i bizneseve të udhëhequra nga gratë është 204.</p> <p>8. Komuna për periudhën raportuese ka mbështetur bizneset në vlerë prej 100,000.00€ dhe 8 biznese të udhëhequra nga gratë, në total 80.000€</p>	
2. TATIMET				Neni 105 Tatimet - MSA
2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;	Drejtoria e Inspektoriatit	1. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale ?	1. Inspektimet e vazhdueshme në terren si dhe procedimi përmes gjobave, përkatësisht në bazë të parashikimeve të legjislacionit në fuqi.	

<p>2.2. Zbatimi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike</p>		<p>1. Sa rekomandime ka dhënë Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në raportin më të fundit për Komunën tuaj.</p> <p>2. Sa rekomandime të ZKA-së i keni adresuar?</p> <p>3. Sa rekomandime të ZKA-së kanë mbetur pa u adresuar?</p> <p>4. Sa rekomandime të ZKA-së gjenden në proces?</p> <p>5. A funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm në komunën tuaj, nëse po sa zyrtarë janë të angazhuar në këtë njësi?</p> <p>6. A ka themeluar komuna juaj komitetin për auditim të brendshëm?</p>	<p>1.Në raportin e fundit të vitit 2023, Zyra Kombëtare e Auditorit ka drejtuar 21 rekomandime.</p> <p>2. Nga këto rekomandime 8 janë përfunduar.</p> <p>3. 13 nga këto rekomandime janë përsëritur.</p> <p>4.Të gjitha rekomandimet janë marrur parasysh dhe po bëhet përpjekje që të trajtohen e realizohen.</p> <p>5.Komuna e Ferizajt ka funksionale Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Të angazhuar janë tre (3) zyrtar.</p> <p>6.Në Komunën e Ferizajt funksionon Njësia e Auditorëve të Brendshëm si dhe ka funksional Komitetin e Auditimit.</p>	
<p>2.3. Planfikimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal</p>		<p>1. A është publikuar regjistri i pronës komunale, bashkangjiti linkun i regjistrin të pronave në kuadër të ueb faqeve zyrtare të komunave?</p>	<p>1.Po është publikuar dhe gjendet në web faqen e komunës, gjithashtu gjeni te bashkangjitur.</p> <p>https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/dokumentet-e-pkgj-se/?page=2024</p>	
<p>3. NDËRMARRJET DHE POLITIKAT E INDUSTRIË</p> <p>13</p>				

3.1.Ndërtimi i një infrastrukture fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve		1. A është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike në komunën tuaj?	1.Ka pasur hapa konkret lidhur me çështjen në fjalë, mirëpo përfundim të projektit nuk ka pasur. Janë në kompetencë të vendimmarrjes të nivelit qendror.	
3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE				
1. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL				Neni 26 i MSA-së: Bujqësia dhe Peshkataria
1.1. Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore	Drejtoria për Bujqësi	1. A ka hartuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar? 2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore? 3.Sa është numri i vendimeve të miratuara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore? 4.A keni raste në komunën tuaj të humbjes së tokës Bujqësore?.	1.Po, Drejtoria e Bujqesisë vepron sipas Planit të Punës. Bashkangjitur gjeni dokumentin: 2.Numri i kërkesave të parashtruara është 39 kërkesa. 3.Numri i vendimeve të miratuara është 34. 4.Jo nuk ka raste të tilla.	
1.2.Konsolidimi i mëtejshëm i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural	Drejtoria për Bujqësi	1. A janë funksionalizuar qendrat informative për këshillimin e fermerëve në komunën tuaj? 2.A ka mbështetur komuna juaj fermerët në sektorin e	1. Po ekziston zyra për informim të fermerëve në kuadër të Drejtorisë së Bujqesisë dhe Pylltarisë. 2. Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Bujqesise ka mbështetur fermerët ne te gjitha sektorët e bujqesisë. Numri i fermerëve	

		drithrave, hortikulturës, blegtorisë etj nëse po ju lutem cekni sektorin dhe numrin e fermerëve të përkrahur?	te përkrahur është 532 fermerë.	
1.3. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore	Drejtoria për Bujqësi	1.Çfarë veprime ka ndërmarr komuna juaj për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore?	1.Komuna e Ferizajt në vazhdimësi stimulon krijimin e punishteve të reja bujqësore, prandaj përmes ekipeve profesionale të drejtoris kontribuon në parandalimin e humbjes së tokës bujqësore.	
1.4. Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi)	Drejtoria e Bujqësisë	1. A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?	1.Komuna e Ferizajt nuk posedon Plan te veqante per Menaxhimin e tokave rurale, por nje plan i tille eshte i perfshire ne Planin Zhvillimor Komunal dhe Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Ferizajt.	
ENERGIJA				Neni 114 Energjia- MSA
2.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqencë të Energjisë, konform Ligjit për Energji Elektrike nëse po, ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ? 2. Cilat janë projektet konkrete për zbatimin e planit për eficientë të energjisë, specifikoni së paku tri projekte?	1. Po, bashkangjitur gjeni Planin për Efiqencë të Energjisë, mbi bazën e së cilit funksionon ky digaster. 2. Vendosja e poçëve eficient në qytet dhe në fshatra, me ç’rast rezulton edhe në kursimin e energjisë elektrike si dhe në bashkëpunim me Fondin e Kosovës për Eficientë të Energjisë - projekte për renovime të objekteve si objekti i Palestrës së Sporteve, objekti i Brigadës së Zjarrfikësvesi dhe në institucione arsimore, ku janë ndërruar dritaret dhe është bërë izolimi i objekteve, vendosja e pajisjeve përkatëse etj. me qëllim kursimi të energjisë.	

4. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE			
4.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut	Njësia për të Drejtat e Njeriut	<p>1. A është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen nga diskriminimit ?</p> <p>2.A është emëruar zyrtari përkatës për Barazi Gjinore?</p> <p>3. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ?</p>	<p>1.Po është emëruar zyrtari (<i>Bashkangjitur gjeni dokumentin</i>).</p> <p>2.Po është emëruar zyrtari (<i>Bashkangjitur gjeni dokumentin</i>).</p> <p>3.Komuna e Ferizajt në vazhdimësi mbështet nismat e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut, posedon edhe njësinë e veçantë në kuadër të kabinetit. Buxhet të veçant nuk ka, por mbështet të gjitha aktivitetet e kësaj fushe.</p>
4.2 Zbatimi i pakove ligjore për Kujdesin për të moshuarit		<p>1.A ofron Komuna juaj përkuajdesje rezidenciale për të moshuarit, konform legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?</p> <p>2.Nëse po, sa qendra të përkuajdesjes për të moshuarit gjenden në Komunën tuaj?</p>	<p>1.Në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kemi edhe Shtëpinë e Komunitetit, që është Qendër Rezidenciale për të moshuar, ku e kemi mbështetur me projekte të ndryshme dhe në aktivitetin e tyre.</p> <p>2.Ekziston Shtëpia e Komunitetit, dhe kemi mbështetur edhe organizata të ndryshme por edhe individë në këtë fushë, pra të banimit social.</p>

<p>4.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, konform strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?</p> <p>2. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna <u>juaj dhe sa janë trajtuar ?</u></p> <p>3.Cfarë masa ka ndërmar komuna juaj për viktimat e dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje ?</p> <p>4.A ka themeluar komuna këshillin komunal (komitet) për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, nëse po sa takime janë mbajtur?</p>	<p>1. Komuna e Ferizajt ende nuk ka hartuar Strategjinë kundër dhunës në familje, mirëpo ekziston Plani kundër Dhunës në Familje, që është në kuadër të Mekanizmit kundër Dhunës në Familje, prirë nga drejtori i DSHMS-së.</p> <p>2.Përgjatë vitit 2024 janë trajtuar rreth 80 raste të dhunës mbi baza gjinore.</p> <p>3. Komuna e Ferizajt ka ndarë një objekt për Strehimoren për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, me ç’rast u del në mbrotje këtyre viktimave sipas rastit.</p> <p>4. Ka të themeluar Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Familje që ka mbajtur 1 takim.</p>	
---	---	--	---	--

<p>4.3.Të fuqizohet roli dhe pozita e grave në shoqëri</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut</p>	<p>1. Sa është numri i grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj) ?</p> <p>2.Sa është numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, dhe komunitetin jo shumicë ?</p> <p>3. Sa është numri i grave që janë Drejtore të Drejtorive në Komunën tuaj?</p>	<p>1.Numri i grave në pozita menaxherial në të gjitha institucionet është 18, në administratë 3, në shkolla 10, në QKMF 3.</p> <p>2. Numri total i përfaqësimit të femrave është 107.</p> <p>3. Numri i grave që janë drejtore të drejtorive në Komunën e Ferizajt është 3.</p>	
<p>4.4.Zbatimi i të drejtave pronësore</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi Gjinore</p>	<p>1. Cilat janë veprimet që ka ndërmmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre?</p> <p>2. Sa prona janë të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve?</p>	<p>1.Me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, në rastin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nga ana e dy bashkëshortëve, janë të liruar nga taksa komunale. Ndërsa është promovuar regjistrimi i pronës në bashkëpronësi e Kryetarit Agim Aliu, për të ndjekur edhe qytetarët këtë shembull.</p> <p>3.Komuna e Ferizajt është kampion në këtë lëmi. Ju lutem shihni linkun: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/nees/komuna-ferizaj-urosevac-eshte-pioniere-sa-i-perket-gjitheperfshirjes-ne-procesin-e-regjistrimit-te-pronave/ Janë rreth 2200 prona në emër të grave.</p>	

<p>4.5. Zbatimi i Ligji për Mbrojtjen e fëmijës</p>		<p>1. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqësohet komuna juaj në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës?</p> <p>2.A është themeluar ekipi për të drejtat e fëmijës sipas UA.06/22 .</p> <p>3. A është organizuar ndonjë fushatë vetëdijësueses-edukese në komunën tuaj mbi promovimin dhe njohjen e të drejtave të fëmijëve në kuadër të EDF.</p> <p>4. A është caktuar zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës ?</p> <p>5. A janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, hapësirat e punës në institucionet publike?</p> <p>6.A janë të qasshme objektet arsimore për personat me aftësi të kufizuar?</p> <p>7.A kane asistencën e duhur në procesin mësimor fëmijët me aftësi të</p>	<p>1.Sfidë mbetet njoftimi sa më i madhë i këtyre kategorive, lidhur me të drejtat e tyre themelore dhe me adresimin e problemit të tyre tek institucionet relevante.</p> <p>2.Po, bashkangjitur gjeni vendimin.</p> <p>3.Është themeluar Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Shtëpia Ime” e cila promovon dhe mbron të drejtat e këtyre kategorive. Si dhe kemi marr pjesë me fushata të ndryshme me rastin e ditëve ndërkombëtare të fëmijës dhe në aktivitet të ndryshme sociale.</p> <p>4.Po është caktuar zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës. <i>(Bashkangjitur gjeni dokumentin).</i></p> <p>5.Institucionet lokale janë pjesërisht të qasshme.</p> <p>6.Te gjitha objektet arsimore janë të qasshme.</p> <p>7.Drejtoria e Arsimit ofron asistenc të nevojshme për personat me aftësi të kufizuar, duke bërë edhe punësimin e stafit përkatës arsimor për fëmijët me nevoja të veçanta.</p>	
---	--	--	---	--

		<p>kufizuar, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?</p> <p>8. A ofron Komuna Juaj kujdestari për fëmijës pa përkujdesje prindërore sipas formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p>	<p>8.Këtë përkujdesje e ofron Qendra për Punë Sociale në Komunën e Ferizajt.</p>	
<p>4.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</p>	<p>1. A është e hapur fushata vjetore në parandalimin e trafikimit me njerëz në Komunën tuaj? Nëse po ju lutem renditni aktivitetet?</p> <p>2.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin tre-vjeçar për strehim Social konform Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit ? Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin?</p>	<p>1.Ende nuk është hapur.</p> <p>2.Planiprogrami për strehim social është miratuar është në fazën finale, bashkangjitur gjeni linkun në të cilin gjeni detajet e diskutimit publik: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/neës/diskutohet-projekt-programi-trevjecare-i-banimit-2023-2025/ gjithashtu në attachment gjeni listën me komente nga diskutimi publik.</p>	
<p>4.7.Incimi i funksionalizmit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar</p>		<p>1.A është themeluar Komiteti konsultative për Personat me aftësi të kufizuara në komunën tuaj? Nëse po sa takime ka mbajtur?</p>	<p>1.Po është themeluar dhe së bashku kanë hartuar Planin e Veprimit për Personat me aftësi të kufizuar. Bashkangjitur gjeni linkun:</p> <p>https://kk.rks-gov.net/ferizaj/neës/perfundoi-punetoria-per-hartimin-e-planit-te-veprimit-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara/</p>	

<p>4.8. Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie</p> <p>7 (shtatë) regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan.</p>	<p>Drejtoria e Administratës</p>	<p>1.A është funksionalizuar Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas ? (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë).</p> <p>2. A janë themeluar në komunë tuaj Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike konform Ligji nr. 04/1-017 për ndihmë juridike falas</p> <p>3. Sa është numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në komunën tuaj?</p>	<p>1. Po, Komuna e Ferizajt ka të funksionalizuar Zyrën Rajonale për ndihmë juridike falas.</p> <p>2. Zonat mobile ende nuk janë funksionalizuar.</p> <p>3.Deri në periudhën raportuese janë 38 kërkesa.</p>	
<p>5 .MBROJTJA E MINORITETEVE</p>				
<p>5.1.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal</p>		<p>1.Sa është numri i të punësuarave në të gjitha institucionet e komunës, nga komunitet jo shumicë në pajtim me përqindjen e popullatës në komunë ?</p>	<p>1. Numri i të punësuarve nga Komunitetet jo shumicë është 13.</p>	

<p>5.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali, përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, dhe ashkali</p>	<p>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</p>	<p>1. A është realizuar fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom Ashkali dhe Egjiptian?</p> <p>2. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni këtë Plan? (për komunat që i kanë këto komunitetet)</p> <p>3. A është themeluar komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin Rom dhe Ashkali.</p>	<p>1. Fushata për regjistrimin falas të komuniteteve Rom, Ashkali realizohet çdo vit gjatë muajit prill.</p> <p>2. Po është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian</p> <p>3. Po është themeluar komiteti Lokal i Veprues për Zbatimin Strategjisë për Komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian .</p>	
<p>6. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA</p>				<p>Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia- MSA</p>

<p>6.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafuar</p>	<p>Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete</p>	<p>1.A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2.A ka themeluar komuna juaj Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR)?</p>	<p>1.Në mbledhjen e Kuvendit Komunal të muajit të 4 është votuar për dalje në diskutim publik, shih: (https://kk.rks.gov.net/ferizaj/nees/kuvendi-i-komunes-mori-nje-sere-vendimesh-te-rendesishme-2/), ndërsa në mbledhjen e muajit të 6, respektivisht të datës 27.06.2023 është votuar plani.</p> <p>2. Po.</p>	
<p>7.MENAXHIMI I KUFIJVE DHE MIGRIMIT</p>				<p>Neni 85- Vizat,menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni-MSA</p>
<p>7.1. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur</p>	<p>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale</p>	<p>1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i shtëpive të (ri)ndërtuara për të rikthyerit?</p> <p>3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim?</p> <p>4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?</p>	<p>1.Gjatë periudhës së raportimit nuk kemi persona të kthyer, kështu që nuk ka as të regjistruar.</p> <p>2.Nuk ka shtëpi të rindërtuar gjatë kësaj periudhe</p> <p>3.Në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk ka pasur asnjë kërkesë, ndërsa në ZKKK gjithësej 23 kërkesa.</p> <p>4. Me rregulloren Nr.13/2017 në ZKKK nuk ka aplikime për Plan Biznese.</p>	

<p>7.2. Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVS) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive</p>	<p>Zyra e Kryetarit Komunës</p>	<p>1. A është themeluar KKSB në Komunën Tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSB ?</p> <p>3. A është themeluar Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ?</p> <p>4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ?</p> <p>5. A është themeluar EVS në Komunën tuaj?</p> <p>6. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga EVS ?</p> <p>7. A janë themeluar Këshillat e Fshatrave në komunën tuaj konform Udhëzimi Administrativ 02/2019 MAPL për bashkpunimin e komunës me fshatra, nëse po të bashkangjiten vendimet perkatëse?</p> <p>8. Sa takime kanë mbajtur në këtë periudhë?</p>	<p>1.Po është themeluar.</p> <p>2. Eshte mbajtur nje (1) takim.</p> <p>3.Po eshte themeluar dhe eshte funksional.</p> <p>4.Gjate periudhës raportuese nuk ka informacion.</p> <p>5.Po eshte themeluar</p> <p>6.Gjate periudhës raportuese nuk ka informacion.</p> <p>7.Po, bashkangjitur gjeni linkun e publikuar ne faqe te Komunes se Ferizajt: https://kk.rks.gov.net/ferizaj/qyteti/kryetaret-e-fshatrave-dhe-zonave-urbane-te-qytetit-te-ferizajt/</p> <p>8.Kryetarët e fshatrave kanë mbajtur një (1) takim – diskutim publik lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhtore 2025-2027 dhe janë ftuar në të gjitha diskutimet publike lidhur me dokumente dhe strategji të ndryshme.</p>	
<p>8. ARSIMI DHE KULTURA</p>				<p>Neni 107 Arsimi dhe trajnimi - MSA</p>

8.1.Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës	Drejtoria e Arsimit	1. Sa trajnime janë mbajtur gjatë periudhës raportuese për mësimdhënës ?	1. Janë mbajtur 9 trajnime ne fusha te ndryshme, përfshirë këtu burimet njerezore, në fushën e ekonomisë dhe financave, auditimit, prokurimit, etj.	
8.2. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta	Drejtoria e Arsimit	<p>1. Sa është numri i çerdheve funksionale (<i>publike dhe jo-publike</i>) në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjec që janë të përfshirë në çerdhe?</p> <p>3.Sa është numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë përfshirë në çerdhe?</p>	<p>1.Në komunën e Ferizajt funksionon 1 (një) çerdhe publike dhe 1 (një) çerdhe publike-private. Gjithashtu janë funksionale edhe 7 çerdhe private.</p> <p>2.Në 2 çerdhet e lartshënuara, janë të përfshirë mbi 400 fëmijë, nga viti shkollor 2023/24, ndërsa për çerdhet private, nuk kemi të dhëna. Në raportimin e fundvitit do të paraqesim numrin total edhe nga regjistrimet e reja në gusht.</p> <p>3.Në 2 çerdhet, janë të përfshirë 35 fëmijë me nevoja të veçanta.</p>	

<p>8.3. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti Rom Ashkali Egjiptian. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit</p>	<p>Drejtoria e Arsimit</p>	<p>1.Komuna juaj a has në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë?</p> <p>2.Sa është numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë?</p> <p>3.A ka organizuar komuna juaj trajnime për ekipet e parandalimit të braktisjes së shkollës, nëse po ju lutem specifikoni numrin e trajnimeve?</p> <p>4. A ka hartuar komuna juaj Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) konform strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, nëse po ju lutemi të bashkangjiteni këtë Plan?</p> <p>5. A janë formuar ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla në komunën tuaj?</p>	<p>1. Në komunën e Ferizajt, nuk zhvillohet mësimi në gjuhët e komuniteteve. Komuniteti ashkali me vet dëshirë, procesin mësimor e zhvillojnë në gjuhën shqipe.</p> <p>2.Sipas të dhënave statistikore që kemi, brenda vitit, kanë braktisuar shkollimin 32 nxënës nga klasa 1-9, kryesisht të komunitetit joshumicë, por numri më i madh i braktisjes është në nivelin e shkollimit të mesëm të lart, ku numri më i madh është nga komuniteti shumicë.</p> <p>3.Drejtoria e Arsimit në bashkëfinancim me programin ROMACTED II të Këshillit të Evropës, ka financuar angazhimin e tre mediatorëve të cilët janë angazhuar për parandalimin dhe kthimin e fëmijëve në shkollë të cilët kanë braktisur mësimin.</p> <p>4. Komuna ka themeluar Ekipin për Parandalim të Braktisjes dhe të mosregjistrimit për gjithë komunitetet.</p> <p>5. Në çdo shkollë janë të formuara ekipet e EPRMB.</p>	
--	-----------------------------------	--	---	--

9. MJEDISI		Neni 115 Mjedisi- MSA	
<p>9.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1. A është hartuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave konform ligjit nr. 04/l-060 për mbeturina. Nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. Sa është numri i fushatave të ndërmara për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave?</p> <p>3. Cilat janë veprimet e ndërmara nga komuna e Obiliqit për mbrojtjen e qytetarëve lidhur me mbylljen e liqenit të depozitës së hirit të qymyrit që operohet nga KEK-u dhe deponisë së Mirashit ? Obiliqi</p> <p>4. A është hartuar plani i veprimit për cilësinë e ajrit në komunën tuaj, konform Ligjit nr. 03/l-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e</p>	<p>1. Komuna e Ferizajt ka hartuar Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave konform ligjit. Bashkangjitur gjeni dokumentin:</p> <p>https://kk.rks-gov.net/ferizaj/ep-content/uploads/sites/31/2022/07/Rregullorja-per-menagjimin-e-mbeturinave-ne-komunen-e-Ferizaj-2022.pdf</p> <p>2. Institucionet e Ferizajt, në koordinim të vazhdueshëm mes vete, trajtojnë çështjen e mbeturinave dhe përmes mediave televizive dhe ato të shkruara dërgojnë mesazhe tek qytetarët për të ruajtur ambientin.</p> <p>3. <i>(Nuk është për Komunën e Ferizajt)</i></p> <p>4. Nuk ka plan të veprimit për cilësinë e ajrit.</p>

		miratuar (<i>shihni nëse Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit janë pjesë integrale e planeve lokale për mjedis</i>) ?		
9.2 Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi?	1. Të identifikuar janë 25 deponi ilegale të mbeturinave, përfshirë deponi te vogla të mesme dhe të mëdha. Së bashku me kompanit përgjegjëse si: K.R.M “Pastërtia dhe N.P.L “Ambienti, kemi filluar me pastrimin dhe eliminimin e këtyre deponive, që i kemi identifikuar.	

10. MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT PUBLIK

Neni 81 Mbrojtja e konsumatorit- MSA

10.1 Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues	Drejtoria e Administratës /Drejtoria e shëndetësis	<p>1. A ka pasur fushata vetëdijësues në komunën tuaj lidhur me shëndetin riprodhues ?</p> <p>2.Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës?</p> <p>3. A janë të qasshme objektet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar?</p>	<p>1.Në 4 QMF-të e qytetit, funksionojnë dhomat e Kujdesit Antenatal (para lindjes) ku përveç monitorimit të gjendjes shëndetësore të shtatzënave ipen edhe këshilla për shëndet riprodhues (deri në muajin Mars këto shërbime janë realizuar me telefon) sikurse edhe shërbimet në Klasën për Gra në QMF-2.</p> <p>2.Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 9 trajnime.</p> <p>3.Po kanë qasje për personat me aftësi të kufizuar.</p>	
--	---	--	--	--